



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
FEDERATA SHQIPTARE E SPORTIT UNIVERSITAR**

**RREGULLORE E AKTIVITETEVE TË FSHSU**

**KAPITULLI I**

**KAMPIONATET E FSHSU**

**NENI 1.** Me këtë rregullore, caktohet sistemi i garave ekipore dhe individuale të FSHSU për të gjitha sportet në të gjitha kategoritë.

**1.1** Vendi, data, ora dhe mënyra e zhvillimit të çdo veprimtarie përcaktohet në kalendarin sportiv kombëtar, në përputhje me strukturën organizative miratuar nga Komiteti Drejtues i FSHSU.

**1.2** Në të gjithë Kampionatet e organizuara nga FSHSU zbatohen rregullat e Federatës Kombëtare Sportive për atë disiplinë dhe kategori sportive.

**1.3.** Kampionatet e FSHSU-së janë gara shumë-sportëshe të shoqatave studentore sportive, të mbajtura çdo vit për ekipet e IAL-ve dhe studentët individualë të emëruar nga shoqatat e tyre studentore sportive të IAL-ve.

**1.4** Fituesit e garave fitojnë titullin "Kampioni i Universiteteve Shqiptare" dhe fitojnë të drejtën të përfaqësojnë vendin në Garat Ndërkombëtare.

**1.5** Pjesëmarrësit e Kampionateve janë shoqata sportive studentore përfaqësuese të IAL-ve dhe institucione të ngjashme me statusin e një institucioni të arsimit të lartë të njohur nga Ministria Përgjegjëse për Arsimin.

**1.6** Anëtarët (garuesit dhe zyrtarët) e çdo IAL formojnë një delegacion, dhe një ekip i tillë zyrtarisht përfaqëson vetëm një universitet.

**1.7** IAL pjesëmarrëse do të përdorin emrin e tyre. Emri i rajonit mund të shtohet gjithashtu, dhe duhet të përdoret në përputhje me emrin dhe shkurtimin, siç njihet nga FSHSU. Nëse përdorimi i emrit të një IAL nuk është i mundur për arsye teknike, atëherë shkurtimi do të përdoret në çdo dokument.

**1.8** Përbërja e një delegacioni përcaktohet në rregulloren teknike të sportit përkatës. Delegacioni nuk mund të përfshijë më shumë garues sesa përcaktohet në rregulloren teknike të sportit përkatës.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË FEDERATA SHQIPTARE E SPORTIT UNIVERSITAR

**1.9** Secili delegacion do të caktojë një Kryetar Delegacioni, i cili vetëm do të ketë të drejtë të përfaqësojë delegacionin e tij. Kryetari i Delegacionit nuk mund të jetë njëkohësisht i regjistruar si garues.

**1.10** Delegacionet do të jenë përgjegjës për koston e tyre të udhëtimit në pikat e caktuara të mbërritjes / nisjes.

**1.11** Delegacionet duhet të kenë sigurimin e duhur për të mbuluar udhëtimin dhe pjesëmarrjen e tyre në Kampionat.

**1.12** Delegacionet do të sjellin 1 (një) flamur (me dimensione 1x2 metra) të IAL-së dhe 1 (një) flamur (me dimensione 1x2 metra) të shoqatës sportive studentore të tyre.

**1.13** Kryetari i delegacionit ose përfaqësuesi i ekipit i autorizuar prej tij mund të ankimojë në emër të garuesve ose ekipit. Ankesat duhet të dorëzohen:

- brenda 20 (njëzet) minutash pas përfundimit të ndeshjes tek Gjyqtari i ndeshjes për çështjet e ndeshjes;
- gjatë garës tek Gjyqtari ndihmës për çështje teknike;
- gjatë garës tek Gjyqtari ndihmës për çështjet jo-teknike;
- brenda shtatë (7) ditëve pas Kampionatit për Komitetin Drejtues të FSHSU për çështjet e Kampionatit.

**1.14** FSHSU mbledh të dhënat e pjesëmarrësve: emrin, adresën, vendbanimin, vendndodhjen, datën dhe vendin e lindjes, kombësinë, numrin e pasaportës, gjininë, universitetin, fakultetin dhe vitin e studimit, numrin e telefonit dhe adresën e emailit. Këto të dhëna trajtohen në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

### **Është e rëndësishme:**

Listat e regjistrimit me të dhënat lartpërmendur, bashkëngjitur nr. të matrikullimit, firmë dhe vulë të rektorit/dekanit, duhet t’i paraqiten koordinatorës të FSHSU në ditën e ceremonisë së hapjes së Finaleve.

## KAPITULLI II

### SPORTISTI UNIVERSITAR

**2.1** Sportistët universitarë janë studentë dhe nxënës që regjistrohen rregullisht, si të tillë, në një



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË FEDERATA SHQIPTARE E SPORTIT UNIVERSITAR

institucion të arsimit të lartë ose në një institucion të ngjashëm, statusi akademik i të cilit është i njohur nga Ministria Përgjegjëse për Arsimin.

**2.2** Shoqata sportive studentore është përgjegjëse për verifikimin dhe vërtetimin e kualifikimit të sportistit universitar. Ekipi i tyre duhet të përbëhet nga jo më pak se 10 dhe jo më shumë se 12 studentë.

**2.3** Për garat kombëtare dhe ndërkombëtare, FSHSU pranon ish-studentë ose studentë nga institucionet e përmendura, të cilët kanë marrë diplomën për kryerjen e arsimit të lartë në vitin që i paraprin ngjarjes. Ata duhet të kenë diplomë bachelor ose ekuivalent.

**2.4** Të gjithë konkurrentët duhet domosdoshmërisht të jenë mbi 17 vjeç dhe nën 28 vjeç në fillim të janarit të vitit të ngjarjes.

### KAPITULLI III

#### GJYQTARI

**3.1** Gjyqtari drejton lojën në pajtim me rregullat e FISU dhe zbaton dispozitat e kësaj rregulloreje.

**3.2** Gjyqtari është përgjegjës për atë çka ndodh brenda hapësirës së lojës.

**3.3** Gjyqtari kujdeset që të ketë në hapësirën e lojës mjetet e nevojshme.

**3.4** Gjyqtari hedh shortin.

**3.5** Gjyqtari ndëshkon lojtarët dhe trajnerët me karton.

**3.6** Gjyqtari është përgjegjës për komandat gjatë lojës.

**3.7** Gjyqtari kontrollon rradhën e shërbimeve, ndërrimin e anëve dhe përmirëson gabime eventuale, sapo i ka kuptuar.

**3.8** Gjyqtari vendos për cdo pikë, përvec kur gjyqtari ndihmës e ka të drejtën e vendosjes.

**3.9** Gjyqtari dërgon tek Kryegjyqtari procesverbalin e ndeshjes/takimit.

### KAPITULLI IV



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË FEDERATA SHQIPTARE E SPORTIT UNIVERSITAR

### GJYQTARI NDIHMËS

- 4.1** Gjyqtari Ndhmës kontrollon kohën e nxemjes, kohëzgjatjen e pushimit e kohëzgjatjen e lojës në ato sporte ku kjo dispozitë aplikohet.
- 4.2** Gjyqtari Ndhmës vendos nëse shërbimet anësore/këndit janë të rregullta në ato sporte ku kjo dispozitë aplikohet.
- 4.3** Gjyqtari Ndhmës asiston/ndihmon Gjyqtarin në konfirmimin e shënimit të pikëve.
- 4.4** Gjyqtari Ndhmës mund të ndërpresë lojën nëse janë shkelur kushtet e lojës në atë mënyrë që mund të ndikonin në rezultatin e lojës.
- 4.5** Vendimet e Gjyqtarit Ndhmës janë të plotëfuqishme kur kanë të bjënë me fakte për të cilat i janë caktuar, në ato sporte ku kjo dispozitë aplikohet.

### KAPITULLI V

#### ORGANIZIMI I VEPRIMTARIVE

- 5.1** IAL/shoqata sportive studentore pritëse në kalendarin e aktiviteteve ose IAL/ shoqata së cilës i është deleguar organizimi i një aktiviteti duhet të garantojë marrjen e të gjitha masave të domosdoshme për zhvillimin normal të ndeshjeve. Ata do të përgjigjen për pritjen, përcjelljen e skuadrave, gjyqtarëve si dhe marrjen e të gjitha masave organizative dhe të sigurisë për zhvillimin normal të aktivitetit.
- 5.2** IAL/shoqatës që i është deleguar e drejta për të qenë organizator i veprimtarisë mund të ndyshojë minimalisht 2 ditë përpara aktivitetit, vendin dhe orarin duke njoftuar në rrugë elektronike dhe/ose me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm të FSHSU dhe Përgjegjës të IAL-së mike.
- 5.3** Për rastet e strehimit të skuadrës në bazë të njoftimit zyrtar të dërguar nga skuadra mike përgjigjet IAL/shoqata pritëse.
- 5.4** IAL/shoqatat janë përgjegjëse për sigurimin e automjeteve të udhëtimit për skuadrat.
- 5.5** FSHSU do të mbulojë shpenzimet për udhëtimin, dietat e gjyqtarëve të ndeshjes dhe sekretarëve të tavolinave, sipas tarifave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- 5.6** Dyzet minuta (40) para fillimit të ndeshjes, përgjegjësit e IAL-ve të përcaktuar në nenin **5.20** duhet të kontrollojnë dokumentacionin e skuadrave (listat e regjistrimit). Ata duhet të kontrollojnë



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË FEDERATA SHQIPTARE E SPORTIT UNIVERSITAR

rregullsinë e dokumenteve (firmat dhe vulat përkatëse), pastaj të japin konfirmimin për regjistrimin e tyre në protokollin e ndeshjes.

**5.7** Personat që nuk janë të regjistruar (federuar), nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndeshje dhe nuk lejohen të futen në territorin e zhvillimit të lojës, si dhe në të gjithë ambientin ku zhvillohet ndeshja.

**5.8** Në tavolinën e sekretarisë duhet të qëndrojnë vetëm sekretari i ndeshjes dhe shënuesi i pikëve. Asnjë person tjetër nuk ka të drejtë të ullet në tavolinën e sekretarisë.

**5.9** Në të gjitha ndeshjet zyrtare apo miqësore IAL / shoqata pritëse në kalendar është përgjegjëse për sjelljen e publikut dhe tifozëve të saj para, gjatë dhe pas ndeshjes. Në të gjitha rastet kur spektatorët do të bëhen pengesë për zhvillimin normal të ndeshjeve, atëherë do të vepronet sipas neneve të mëposhtëm:

**5.10** Në pallatet e sportit apo sallat sportive ku ndodhin thyerje të Rregullores së Brendshme dhe Kodit të Etikës, të cilat pengojnë zhvillimin normal të ndeshjes nga ana e tifozëve të njëjës skuadër, Komisioni i Disiplinës i FSHSU vendos për zhvillimin e ndeshjeve në këto pallate apo salla sportive, pa praninë e publikut.

Lejohen të aktivizohen në këtë rast: Skuadrat, trajnerët, përgjegjësit e klubeve, mjek apo masazhator, gjyqtarët e delegati teknik, si dhe organet e Rendit Publik.

**5.11** Në rast se rregullimet do të vazhdojnë dhe do të ndikojnë direkt në rezultatin përfundimtar të ndeshjes, atëherë Komisioni i Disiplinës i FSHSU vendos për pezullimin e ndeshjeve në këtë pallat apo salla sportive, për një periudhë të caktuar ose përgjithmonë dhe IAL / shoqata sportive studentore (pritëse në kalendar) gjobitet sipas akteve nën ligjore (100.000 lekë).

**5.12** Vetëm kapiteni i lojës ka të drejtë të komunikojë me gjyqtarët gjatë ndeshjes. Nuk lejohet që personat e tjerë të cilët janë në stolin e skuadrës të komunikojnë me gjyqtarët e lojës, gjatë ndeshjes.

**5.13** Për fitimin e veprimtarive kombëtare FSHSU vlerëson skuadrat, lojtarët e trajnerët me stimuj moralë e materialë si më poshtë:

- Kupa
- Medalje
- Diploma

**5.14** Ndalohet kategorikisht, në çdo rast dhe për asnjë arsye prekja, kërcënimi apo fyerja e gjyqtarëve nga ana e trajnerit dhe çdo anëtar i skuadrës gjatë zhvillimit të ndeshjes. Me **KËRKESËN** e gjyqtarit të I-rë, vetëm kapiteni i lojës ka të drejtë të komunikojë me gjyqtarin e I-rë.

**5.15** Topat e nxemjes sigurohen nga vetë ekipet pjesëmarrëse. Topat e lojës sigurohen nga Federata Shqiptare e Sportit Universitar

